

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL VITI**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **657-26-4837-5-2-1**

Sa i përket tenderit për **Renovimi i shkollave dhe i të gjitha institucioneve komunale në Komunën e Vitisë.**

ANKESË

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

“BONN PROJET” SHPK

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)
Ulpian, Muje Krasniqi, C5

(Adresa)
Prishtinë

10000

(Vendi)
049/221198

(Kodi postar)

(Numri Telefonit)
Valbon Sherifi

(Numri i Faks-it)

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
Bonni.shpk@gmail.com

(Adresa elektronike)

06.07.2026

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

AK: KUVENDI KOMUNAL VITI

- **-B05 Njoftim per Kontrat me date : 23.06.2026**
- **Dosja e Tenderit me date : 23.06.2026**
- **Përshkrimi i çmimeve me date : 23.06.2026**

- **Kërkesa për Ri-shqyrtim dorezuar në AK me dt 30.06.2026**
- **Pezullimi i Aktivitetit. (NUK KA BERE PEULLIM AK)**
- **Vendimi i AK në Kërkesën për rishqyrtim me date 02.07.2026**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- **Neni 1 Qëllimi**
- **Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi**
 - Neni 27 Dosja e Tenderit
 - Neni 28 Specifikimet teknike
 - Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave
- Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
- Neni 64 Dëshmitë e kërkesave
- Neni 65 Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve
- **Neni 66 Përshatshmëria Profesionale**
- **Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale**
- **Rregulloren e Punës e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik në Kosovë**

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Me datë: 23.06.2026 AK: KUVENDI KOMUNAL VITI

Ka Publikur Njoftimin për Kontrat, ku pas Analizimit të Dosjes së Tënderti dhe Kragasueshmerin e Paramases me Punet e kryera që do behen kemi vrejtur mos përputhje të medh mes vete, dhe Favorizim të AK-se për një OE të caktuar, duke bërë shkelje të NENIT 7 të LPP-se. Dhe me datë 30.06.2026, kemi bërë kërkesën për Ryshqyrtim, ku AK, ka vlersuar si të jashtafatshme, duke e refuzuar ta Ryshqyrtoj.

Autoriteti Kontraktues ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim me arsyetimin se ajo është dorëzuar pas orës 16:00.

Ky arsyetim është juridikisht i pabazuar.

Vetë Autoriteti Kontraktues pranon se kërkesa është pranuar më **30.06.2026 në ora 16:55**, ndërsa refuzimi mbështetet vetëm në interpretimin se pas orës 16:00 dita konsiderohet e përfunduar.

Ky interpretim nuk mbështetet në dispozitat materiale të Ligjit për Prokurimin Publik.

Ligji përcakton afate në **ditë**, ndërsa Autoriteti Kontraktues ka krijuar një kufizim shtesë duke e transformuar afatin ligjor në një afat që përfundon në orën 16:00, pa analizuar nëse kjo është në përputhje me ligjin dhe me funksionimin e platformës elektronike të prokurimit.

Andaj me këte Ankesë Ne i Drejtohem Organit Shqyrtues të Prokurimit, që ta marrë parasysh të drejtën e Ankesës sone në AK, dhe ta Detyroj AK-në ta Ryshqyrtoj Kërkesën pasi që ne Pretendojmë që jemi në afat kohor të rregullt. Dhe Aludojmë që AK ka bërë shkelje të medha Procedurale gjatë kësaj Procedure të Tenderimit të cilat do i paraqesim me posht:

Me datë 30.06.2026 . Ne kemi bërë kërkesën për Ryshqyrtim duke kërkuar që AK të korigjoj disa specifikime të vendosura në FDT, të cilat janë në kundërshtim me Ligjet e Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës të cilat do i paraqesim si në vijim:

Pretendimi 1

Duke iu referuar DOSJES SE TENDERIT saktësisht:

Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesa 1. . Operatori ekonomik duhet të

Dëshmia e kërkuar dokumentare

ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme, si dhe Operatori ose Grupi i operatoreve ekonomik duhet të ofroj se paku nje kontrate te mirmbajtjeve (objekte shkollore) në 3 (tri) vitet e shkuara për periudhën deri në publikimin e njoftimit për kontratë (Formularit B05). **Kontratat e paraqitura duhet të paraqesin vlerën e se paku sa Vlera e planifikuar e kontratës, dhe në rast grupit të Operatoreve Ekonomik, lideri i paraqitur duhet të paraqes se paku 60% të kërkesës se vlerës financiare.**

Pra ne baze te kesaj Ak ka specifikuar ne menyrr strikte qe punet e ngjashme duhen te jen "MIRBAJTJE e OBJETEVE SHKOLLORE" **Kontratat e paraqitura duhet të paraqesin vlerën e se paku sa Vlera e planifikuar e kontratës,** Me qka konsiderojm qe eshte ne kundershjim me Natyren e Punëve per qka është thirrur kjo kontrat, sepse duke e analizur Paramasen dhe dosjen e tenderin kemi mosperputhje te kerkeseave, ku ne bazë te POENTIMIT me 70% Poentohen punet furnizim dhe Montim dhe ketu kerkohen 100% punet e ngjashme vetem Mirmbajtje

Pra ne kerkesat e Deshimeve te puneve te ngjashme te perfunduara ne 3 vitet e fundit, Ak eshte komplet ne Kundershjim me Ligjet e prokurimit Publik, dhe ne kete Rast neni 7 i LPP-se.

Iu lutem keto janë diskriminime te plote dhe NE kundershjim me qdo parim te Konkuresces se lire dhe trajtimit te barabar te OE-ve qe konsiderojn te jete pjesmarres ne kete Procedur.

Te gjitha keto jan ne kundershjim te plot me Rregullren e KRPP-se dhe Ligjit te Prokurimi Publike te Kosoves. Konkretisht:

Kërkesa që ke paraqitur mund të jetë në kundërshtim me:

- Nenin 7 – parimet e barazisë dhe konkurrencës
- Nenin 28 – specifikimet teknike jo diskriminuese
- Nenin 65 – proporcionaliteti i kapacitetit financiar
- Nenin 69 – proporcionaliteti i kapacitetit teknik

Ak duhet ta harmonizoj Dosjen mes Kerkesave dhe Paramases, sepse punet qe do kryhen ne baze te paramases janë Pune ku mund te permbushen edhe me Pune te ngjashme RENOVIM dhe NDERTIM

Një mënyrë e tillë e përcaktimit të përvojës së ngjashme krijon kufizim artificial të konkurrencës pasi që kërkon nga operatorët ekonomikë të kenë përvojë të njëkohshme në një gamë shumë të gjerë dhe specifike .Kjo qasje tejkalon nevojën reale për të dëshmuar kapacitet teknik dhe profesional për realizimin e kontratës dhe rrjedhimisht favorizon vetëm operatorë të caktuar që mund të kenë realizuar projekte identike me ato të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues. Ku ne kete rast me posht do e deshmojm qe nuk jan leshime teknike nga ana e AK-se, por është Favorizim ii njenashme dhe keto Specifika INDENTIKE kan qene dhe ne proceduaren e tenderit tjeter me Titull: Ndërtimi i palestrës sportive shkollore (Sh.f Sllatinë e Epërme)- Faza e dytë. Ku ne procesverbalin e hapjes se dates

29.06.2026 shihet qe ka konkuruar vetem nje OE e veteme, duke minimizuar ne maksimum konkurrencen.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Prokurimin Publik, autoritetet kontraktuese janë të obliguara të sigurojnë trajtim të barabartë, mos-diskriminim dhe konkurrencë të drejtë ndërmjet operatorëve ekonomikë. Vendosija e kriterëve shumë specifike dhe kumulative për përvojën e mëparshme bie ndesh me këto parime pasi kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë që kanë përvojë relevante në projektim të infrastrukturës, por që nuk kanë realizuar saktësisht të gjitha kategoritë dhe parametrat e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues.

Po ashtu, **sipas nenit 69 të këtij ligji**, kriteret për kapacitet teknik dhe profesional duhet të jenë proporcionale dhe të ndërlidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës. Kërkesa për një numër të madh projektesh të ndryshme infrastrukturore me specifikime të detajuara teknike nuk mund të konsiderohet proporcionale me qëllimin e vlerësimit të kapacitetit profesional të operatorëve ekonomikë, pasi që përvoja në projektim të infrastrukturës mund të dëshmohet edhe përmes projekteve të ngjashme në natyrë dhe kompleksitet, pa qenë e nevojshme të përmbushen të gjitha kategoritë e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues.

Gjithashtu, në përputhje **me nenin 28 të Ligjit për Prokurimin Publik, specifikimet teknike** dhe kërkesat e tenderit nuk duhet të krijojnë pengesa të panevojshme për konkurrencë. Në rastin konkret, kërkesa për parametra të saktë si gjatësia minimale e urave, gjatësia e rrugëve me numër të caktuar korsish apo dimensionet e projekteve hidraulike përbën një kufizim të panevojshëm dhe të pajustificuar për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Duke marrë parasysh sa më sipër, Operatori Ekonomik konsideron se kriteret e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues për përvojën e ngjashme janë të paarsyeshme, joproportionale dhe në kundërshtim me nenet 7, 28 dhe 69 të Ligjit për Prokurimin Publik. Për këtë arsye kërkohet nga Autoriteti Kontraktues që të rishikojë dhe të modifikojë kriteret e përvojës së ngjashme në mënyrë që ato të jenë proporcionale dhe të mos kufizojnë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Pretendimi 2

Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kerkesa 2 Pika 2 (Udheheqesi i Punishtes)

2. Udheheqesi i punishtes; kërkohet te jetë Inxhinier (master) i diplomuar i Ndertimtarise me pesë vite përvojë pune dhe i licencuar, i certifikuar me IWS, si dhe i certifikuar për efqienc te energjisë.

Pra Ak kerkon ne DTF qe Ingjinieri i Ndertimtaris te jete i Certifikuar per vec Auditimit te Energjis dhe me **Certifikat IWS**, ku nese e analizojm Ak po e percakton qe Saldimet te kryhen nga vete Ingjinieri dhe jo nga punonjesit. Pasi qe IWS eshte stadart i Saldimeve, dhe menojm qe kjo duhet te kerkohe tek stafi teknik dhe jo te mendojm qe Ingjinieri te jete Udheheqes i Punishtes aq me pak nje Profesionist Ingjinier i Diplomur por te jte njekohezisht edhe Saldues. (është fyerje per nje Profesionist te till) dhe kerkojm qe te hiqen si pik.

(Ne duam te besojm qe jan leshime teknike nga ana e AK-se, por nuk po na bindin jo prporcionaliteti aq i madhe mas vete)

Pretendimi 3

Lista e Pajisjeve dhe Makineris

	Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve	Sasia e kërkuar (Copë)
1.	Kamion per transport te materialit me kapacitet jo me pak se 10m3	3 Copë
2.	Kamion kiper me kran me peshe maksimale te ngarkese se lejuar deri 5t	1 Copë
3.	Eskavator deri 15 ton	1 Copë
4.	Gjysemrimorkio kiper me peshe bartese max 8ton	1 Copë
5.	Drrasa ndertimi min 350m2	1 Copë
6.	Kompresor gjysmërimorkio per thyerje të betonit	1 Copë
7.	Skele levizëse	2 Copë
8.	Damper me peshë bartëse deri 4 T.	1 Copë
9.	Ngarkues me lopatë dhe fshesë për pastrim 2-5 T.	1 Copë
10.	Semafor sinjalizues vetëlëvizës.	1 Copë
11.	Rul ngjeshës me gjemba, deri 2 T.	1 Copë
12.	Instrument nivel matës me laser	1 Copë
13.	Makinë speciale per perzierje te gletit, fasades, ngjitesit, mases rrafshuese	1 Copë
14.	Gjysemrimorkio gjenerator me ndriqim 1t	2 Copë
15.	Makina per ngjyrosje te brendshme	2 Copë
16.	Zhiraf për grryerje të gledit	2 Copë
17.	Çekan elektropneumatik	1 Copë
18.	Gyp special per hedhjen e mbeturinave nga lartesia min (15m)	Min 15m
19.	Thithëse pluhuri industriale me vibrim	1 Copë
20.	Prerëse për keramika	2 Copë
21.	Rrethoja punishtes minimim 250 m	Min 250 m
22.	Instrument Gjeodezik-GPS, Stacion total për përcjellje e punëve.	1 Copë

23.	Thithese te lageshtisë	1 Copë
24.	Paletar elektrik	1 Copë
25.	Kontenjer WC	1 Copë

Ne listen e Makineris e shohim qe Ak ka kerkuar 25 makineri te Ndryshme ne mesin e tyre edhe Pajisje komplet te panevojshme me natyren e punës, dhe ate vetem e vetenm pse nje OE i posedon. Andaj kerkojm nga Ak qe ta beje Analizen e puneve qe do kryhen dhe ta barazzpeshoj me kerkesen e pajisjeve (Makinerive) qe po ti shohesh vetem makinerit ne fillim te mendon qe do fillojm te bejm infrastruktur Rrugore dhe jo Renovim te Objekteve.

Ne kemi Kerkuar nga Ak qe nga litsa e Makineris pikat: 9. 10. 14 te hiqen nga liste per te mundesuar Pjemarrje te barabart te konkurrences ne kete procedur, pasi qe Ak nuk ka te drejt ta caktoj peshen specifike si me lart tek pika 14 ku kerkohet:

14.	Gjysemrimorkio gjenerator me ndriqim 1t	2 Copë
-----	---	--------

Pra kerkohen specifikesht qe Gjysmerimorkio Gjenarator me Ndrdqim ti kete vetem 1Ton, (Nuk lejohet 999 Kg nuk lejohet 1001 Kg), kjo eshte “KONTRABANDIM” i Tenderit tek nje OE tjetër dhe shkelje e te Dispozitive ligjore.

Apo te shiqojm piken 9 e cila kerkon edhe kjo pesh specifike:

9.	Ngarkues me lopatë dhe fshesë për pastrim 2-5 T.	1 Copë
----	--	--------

Pra Ak duhet te jete ne dijëni qe keto specifika munde te kerkohen me Max. Ose Min. Dhe jo te caktohet pesh specifike e ne disa raste edhe pesh Konkrete ose kaq ose hiq.

Ne kemi kerkuar nga AK qe ti heq keto pika diskriminuese dhe komplet Favorizuese pasi qe janë ne Kundershtim me Ligjin e Prokurimit Publik te Republikës se Kosoves dhe Rregullores se KRPP_se. Por e njeta nuk e ka pare te arsyeshme qe ta ryshqyrtoj Kerkesen me Pretendimin e afateve kohore, ku sipas interpretimeve ter ndyrshme ne jemi ne afat kohor te rregullt.

Andaj ne si OE kerkojm nga OSHP qe ti marr si të bazuara pretendimet tona dhe proceduara te ktheht Korrigjim, dhe AK ta beje FDT ne harmoni me kerkesat qe jan edhe ne pramas duke eliminuar specifikat Favorizuese.

E nderuara OSHP ne kerkojm qe te respektohen dhe Shfrytezohen Fondet e republikës se Kosoves ne menyrtansarente dhe te mos abuzohet me to, Pasi nga Pervoajat e kaluara e dime qe “KONTABANDIMET” e ngjashme me kritere diskriminuese e rrisin edhe koston e puneve, dhe Cmimi githmon eshte me larte dhe kemi te bejm me Abuzim direkt te Findeve Publike , pasi qe konkurenca eshte e diskulifikuar ne procedur ende pa filluar.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Natyrishë si një OE që merret vetëm me këtë veprimtari ne në këtë procedurë jemi të dëmtuar materialishtë, financiarishtë dhe moralishtë, sepse jemi në mesin e OE të cilët merren vetëm me këtë veprimtari dhe diskriminimi që na është bërë na dëmton shumë dhe vlerat e dëmëve për ne janë mjaft të mëdha.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) *një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) *një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) *bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) *Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*